



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 2276/Prot.  
13

Pogradec, më 30 . 05.2024

VENDIM

NR. 60 , DATË 29 . 05 .2024

“PËR MIRATIMIN E VËNDNODHJES SË TERMINALIT TË TRANSPORTIT PUBLIK PËR BASHKINË POGRADEC, MIRATIMIN E TARIFAVE DHE RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT”.

Në mbështetje të nenit 23, pika 6, nenit 53, gërma k), e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar, nenit 21/1, ligjit nr. 8308, datë 18/03/1998 “Për transportin Publik”, i ndryshuar dhe Udhëzim Nr. 446, datë 10.5.2018 “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve” me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI :

1. Të miratojë Vëndodhjen e terminalit të transportit publik për Bashkinë Pogradec me adresë, rruga Unazë, zona industriale, Pogradec sipas planvendosjes së Aneksit I bashkangjitur.
2. Të miratojë tarifat e operimit të terminalit të transportit publik për Bashkinë pogradec sipas Aneksit II Bashkangjitur dhe konkretisht:

TARIFA – ORARË

- |   |                                    |  |
|---|------------------------------------|--|
| - 0-10 MIN  | PA PAGESË                          |  |
| - 0-1 ORE   | 200 LEKË                           |  |
| - 1- 5 ORE  | 500 LEKË                           |  |
| - 5-24 ORE  | 800 LEKE TARIFA PËR ÇDO ORAR LINJE |  |
| - Mjetet 6+1 dhe 8+1  | 150 lek per ore                    |  |
| - Autobuzë të transportit rrethqytetas të Bashkise Pogradec | 100 LEKË                           |  |
| - Autobuzë të transportit rrethqytetas të Bashkive te tjera | 200 LEKË                           |  |
| - Autobuzë të transportit ndërqytetas brenda Qarkut Korçë   | 350 LEKË                           |  |
| - Autobuzë të transportit nderqytetas jashtë Qarkut Korçë   | 500 LEKË                           |  |



- Autobuzë të transportit ndërkombëtar

700 LEKË

\* *Parkimi për personat me aftësi/lëvizshmëri të kufizuar është pa pagesë.*

3. Të miratojë rregulloren e funksionimit me shtojcat përkatëse me tekst sipas aneksit III bashkangjitur.
4. Administrata e Bashkisë të marrë masat për mbylljen e gjithë vëndqëndrimeve të mjeteve të transportit publik, qytetars, rrethqytetas, kombetare dhe ndërkombëtare në qytet.
5. Autorizohet Kryetari i Bashkisë që në zbatim të nenit 8, pikës 1 të udhëzimit nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve", të lëshojë autorizimin për terminalin e transportit publik për Bashkinë Pogradec me adresën e mësipërme pasi të verifikojë plotësimin e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në udhëzim.
6. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohen administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
7. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 21 vota

2.Vota Pro 21

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 2

5.Zbardhur më date 30.05.2024